

V E N D I M
Nr. 193, datë 22.4.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKM NR.38, DATË 31.1.1994 “PËR TRAJTIMIN E
NDIHMAVE HUMANITARE FALAS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.38, datë 31.1.1994 bëhen këto ndryshime:

1.Pika 2, ndryshohet si vijon:

“Komisioni përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Pushtetit Lokal, Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Ministrisë së Shëndetësisë.

Përbërja e Komisionit miratohet nga Kryeministri mbi bazën e propozimeve të titullarëve të ministrive përkatëse”

2.Pika 11, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko